



Prishtinë, 28 janar 2016
Kodi i ZRRE-së: V_775_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenit 14 paragrafi 2, nënparagrafi 2.2, Nenit 25, Nenit 29 dhe Nenit 30 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 4, Nenit 6 dhe Nenit 18 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë; dhe
- Aplikacionin për licencim të aktivitetit të importit, eksportit dhe transitit të energjisë elektrike të dorëzuar në ZRRE me datë 28.07.2015 nga ndërmarrja "ENERGY FINANCING TEAM" L.L.C., adresa: Fehmi Agani 1/16, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Në seancën e mbajtur me datë 28 janar 2016, nxori këtë:

VENDIM

- I. **I LËSHOHET** Licenca për import, eksport dhe transit të energjisë elektrike ndërmarrjes "ENERGY FINANCING TEAM" L.L.C., me numër licence ZRRE/Li_44/15 për periudhën nga data **28 janar 2016** deri **27 janar 2021**.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 28.07.2015 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit për import, eksport dhe transit të energjisë elektrike nga ndërmarrja "ENERGY FINANCING TEAM" L.L.C.
- ZRRE ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të ZRRE-së dhe kërkesave/dëshmimeve të parapara në Aplikacionin për Licencim të aktivitetit për import, eksport dhe transit të energjisë elektrike.
- Pas dorëzimit nga kompania në fjalë të të gjithë dokumenteve dhe dëshmimeve të kërkuara sipas aplikacionit, ZRRE ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


- II. Licenca për import, eksport dhe transit të energjisë elektrike i lejon të licencuarit që të kryejë aktivitetin e sipërpërmendur të energjisë elektrike në Kosovë me kapacitet deri **400 MW**, në pajtim me Licencën dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit "ENERGY FINANCING TEAM" L.L.C.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe


Bordi i ZRRE-së:


Enver Halimi, kryesues


Krenar Bujupi, anëtar


Arsim Janova, anëtar


Qemajl Mustafa, anëtar


Besim Sejrićaj, anëtar